



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-057
Prishtinë, më 23 mars 2009, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-31

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 MARS 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Slobodan Petroviq, ndërsa mungoi Nexhat Daci.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Mufera Sinik, ndërsa munguan: Ardian Gjini, Bojan Stajanoviç dhe Sllavisha Petkoviç.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala;

Nga NDI: Rinor Beka dhe

Nga Ambasada Amerikane: Robert Newsome.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe tri pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e kryetarit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 mars 2009,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 26 mars 2009,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 mars 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 16 mars 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare më 26 mars 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që seanca plenare e radhës të mbahet **më 26 mars 2009**, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 12 mars 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
6. Rishqyrtimi i Ligjit për shpronësim,
7. Shqyrtimi i vërejtjeve të Presidentit në Ligjin nr.03-L-118 për tubimet publike,
8. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi, dhe
9. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Raportin konsultativ të tarifave për energji elektrike për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion. lidhur me Raportin konsultativ të tarifave për energji elektrike për vitin 2009, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, kryesuesin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, kryetaren e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion dhe me përfaqësuesin e USAID-it, të mbajnë një mbledhje të përbashkët për të shqyrtuar çështjen e rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

3.2 Shqyrtimi i Propozimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit jo-ekzekutiv të Bordit Drejtues të BQK-së.

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozimin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit jo-ekzekutiv të Bordit Drejtues të BQK-së, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta shqyrtojë propozimin e Bordit Drejtues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtari jo-ekzekutiv në Bordin e BQK-së dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

4. Te ndryshme:

4.1 Njoftim me Raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me zbatimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Kryesia u njoftua me Raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me zbatimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

4.2 Njoftimi me shkresën e Qeverisë së Kosovës lidhur me kërkesën e Kuvendit për saktësimin e datave për procedimin e projektligjeve në Programin e punës së Kuvendit për vitin 2009

Kryesia, pasi u njoftua me shkresën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta hartojë një raport, që të evidencohet nevoja për zhvendosjen e datave të procedimit të projektligjeve nga ana e Qeverisë, si dhe emërtimin e saktë të tyre.

4.3 Njoftimi për fillimin e punës së Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore të Kosovës

Kryesia u njoftua për fillimin e punës së Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore.

4.4 Rekomandimi lidhur me pjesëmarrjen në seminarin e organizuar nga Parlamenti Evropian në Bruksel

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në përbërje: Bahri Hyseni, Lutfi Haziri, Ardian Gjini dhe Enis Kervan, si dhe Minire Hasani dhe Adelina Demolli, nga administrata e Kuvendit, në Bruksel, prej datës 30 mars deri më 02 prill 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit mbulohen nga buxheti i Kuvendit, me mundësi të rimbursimit nga Parlamenti Evropian.

4.5 Kërkesa e deputetit Ibrahim Gashi për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sofje

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit Ibrahim Gashi, në Bullgari, prej datës 25 deri më 27 mars 2009.
2. Udhëtimi sipas paragrafit 1 (një) të këtij vendimi realizohet me makinë dhe në shpenzime të Kuvendit. Shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë (30%) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

4.6 Emërimi i kandidatit Danush Ademi deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia u njoftua me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Danush Ademi, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e PDAK-së.

4.7 Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimet e subjekteve politike për formimin Komisionit ad hoc, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Në përbërjen e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës të përfshihet nga një anëtar i secilës parti politike, që është e përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
2. Partitë politike, që ende nuk e kanë propozuar anëtarin në Komisionin ad hoc, duhet propozimin ta paraqesin në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 14:56 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**